



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e huaj për qëllime specifike

Ngarkesa: 6 kredite, 60 orë mësimore; 30 orë leksione + 30 orë seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master në “Mësuesi”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore:

Kjo lëndë zhvillon te studenti aftësinë: për të dalluar karakteristikat e gjuhës së specialitetit në aspektin leksikor, gramatikor e tekstor; për të hartuar orë mësimore që përqendrohen në mësimdhënien e gjuhës së specialitetit për një kontekst të caktuar si dhe materiale mësimore përkatëse; për të ndihmuar nxënësit në përvetësimin e një fjalori profesional dhe ta aplikojnë atë në mënyrë efektive; për të nxitur kompetencat gjuhësore në situata ku kërkohet përdorimi i gjuhës së specialitetit

Objektivat specifikë lëndorë:

1. Të analizojnë nevojat komunikuese të nxënësve në kontekstin e gjuhës së specialitetit;
2. Të krijojnë përmbajtje të përshtatshme mësimore;
3. Të familjarizohen shpejt me gjuhën e specialitetit në disiplina të ndryshme dhe të përshtatin me fleksibilitet materialet mësimore
4. Të njohin dhe integrojnë dallimet kulturore në kontekste profesionale në mësimdhënien e gjuhës së specialitetit.

Rezultate të pritshme:

Ky kurs do të krijojë mundësi që studenti të njohë dhe dallojë vendin e një gjuhëve specifike në raport me gjuhën standarde të përdorimit në komunikimin e përditshëm pa ngjyresat specifike të lidhura me fushat e përdorimit specifike të saj. Ai do të krijojë një ndërgjegjësim mbi të veçantat që e bëjnë gjuhën për qëllime specifike të ndryshme nga gjuha e përditshmërisë. Përdorimi i këtyre njohurive në praktikë është thelbësorë për studentin në rolin e tij si mësues me nxënës dhe persona që mësojnë gjuhën për ta praktikuar atë në fusha të ndryshme të profesioneve të tyre